VENDIM
Nr.102, datë 18.2.2005

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2005, në shumën 251 976 571 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1
STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2005

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzime gjithsej:	251 976 571
1	Paga	39 476 571
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore	7 200 000
3	Materiale	4 700 000
4	Shërbime	20 800 000
5	Investime	179 800 000